



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

NR. 50, Datë 05/07/2022

“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z. KSENOFON OREST DILO”

Në kuadër të vlerësimit të figurës së Z. Ksenofon Orest Dilo si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit", V.K.M Nr. 861, datë 10/12/2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit", Këshilli i Bashkisë i mbledhur në datën 05.07 2022, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, për dhënie titulli "Qytetar Nderi" për Z. Ksenofon Orest Dilo si dhe mbështetur në relacionin e Komisionit Vendor për dhënien e titujve të nderit,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e titullit **“Qytetar Nderi”** për Z. Ksenofon Orest Dilo me motivacionin:

“Piktor, skenograf dhe kostumograf me prirje novatore dhe moderne i cili e derdhi pa kursim talentin e tij dhe qëndisi dekoret e Festivalit Folklorik Kombëtar me elementët më të qenësishëm të kulturës gjirokastrite”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë dhe Sporteve dhe Drejtoria e Urbanistikës
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” .

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Lavdi Hasani

